



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	16.11.2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jednitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	5476/2021		11/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.833/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.833/2021 të datës 27.09.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Sami Frashëri", Nr. 17 në Komunën e Pejës, kundër organit të punësimit-Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.833/2021 e datës 27.09.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KA.nr.41/2021 i datës 23.08.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

### A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka shpallur konkursin me Nr.03/2021 për pozitën "Zyrtar Ligjor 1" për Gjykatën Themelore në Pejë, në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ankuesi dhe i njëjti është përfshirë në listën e shkurtër dhe është ftuar të merr pjesë në testin me shkrim. Ankuesi në testin me shkrim nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil është vlerësuar me 48 pikë. Ankuesi i pakënaqur me vlerësimin e testit me shkrim, më datë 17.08.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për vlerësim të testit pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 23.08.2021 ka nxjerr Vendim KA.nr.41/2021 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si te pa bazuar duke e lënë në fuqi listën e kandidatë që cilët kanë kaluar testin me shkrim.

Ankuesi kundër Vendimit me numër KA.nr.41/2021 të datës 23.08.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përmes emailit më datë 23.09.2021 në [ankesa.kpmsnck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsnck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 27.09.2021 dhe është regjistruar me numër A.nr.833/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.10.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 14.10.2021 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr.833/2021 të datës 27.09.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.nr. 41/2021 të datës 23.08.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Letërnjoftimin e ankuesit; Dëshmi e datës 23.08.2021 dhe 25.08.2021; Emailin e datës 23.09.2021 dhe 27.09.2021 të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.10.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 14.10.2021 Konkursin e Jashtëm Nr.03/2021 i datës 20.05.2021 nga SKGJK; Ankesën e datës 17.08.2021 të parashtruar nga ankuesi për Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën për punësim e datës 01.06.2021 të ankuesit; Diplomën Nr.2208 të ankuesit, Diplomën e datës 10.06.2005 të ankuesit; Certifikatën e datës 26.06.2019 në emër të ankuesit; Vërtetimin e datës 28.05.2021 në emër të ankuesit; Certifikatën e datës 15.01.2009 në emër të ankuesit; Testin me shkrim të datës 30.07.2021 në emër të ankuesit; Njoftimin për Përzgjedhjen përfundimtare i datës 20.08.2021; Shkresën për propozimin për emërimin e kandidatit të rekomanduar e datës 20.08.2021; Raportin final të rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 19.08.2021; Shkresën për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formularin për vlerësimin individual të kandidatëve; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Formularin për përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin për përcaktimin e kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë i datës 23.07.2021; Deklaratat për mosekzistim të konfliktit të interesit e datës 23.07.2021; Udhëzuesin për testin me shkrim i datës 30.07.2021; Formularin për vlerësim të testit me shkrim dhe me gojë për kandidaten Kërkesën për punësim të kandidatës te datës 02.06.2021 me dokumentet Diploma, Certifikata dhe Vërtetime; Formularin e vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë të kandidatit Testin me shkrim të kandidatit Kërkesën për punësim te datës 02.06.2021 te kandidatit me dokumentet Diploma, Certifikata dhe Vërtetime; Formularin e vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë për kandidatit Testin me shkrim të kandidatit



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.833/2021

**Avdyll BEKTESHI**

*Avdyll Bekteshi*  
**Procesmbajtës**



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

